



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:297209

Datë: 29.10.2024

Numri i dokumentit: 06366385

Ac.nr.1098/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Adnan Konushevc - kryetar i kolegjit, Naime Ahmeti dhe Qerim Ademaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit, N. T. nga fshati P., Komuna e P., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit N. E., avokat nga P., kundër të paditurit Xh. R. nga fshati K. M., Komuna e R., të cilin e përfaqëson, përfaqësuesi i përkohshëm B. H., avokat nga Komuna R., më objekt kontesti borxh, në vlerë prej 17,000.00 euro, duke vendosur për ankesën e paraqitur nga përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë - Dega në Rahovec, C.nr.333/2011 të datës 27.10.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur, me datë 28.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pa themeltë ankesa e përfaqësuesit të përkohshëm të paditurit Xh. R. nga fshati K., Komuna e R., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë - Dega në Rahovec, C.nr.333/2011 i datës 27.10.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar C.nr.333/2011 i datës 27.10.2021, ka vendosur si në vijim: “ I. APROVOHET padia dhe kërkesëpadia e paditësit N. T. i nga fshati P., Komuna e P., në mënyrën si vijon: II. OBLIGOHET i padituri Xh. R. i nga fshati K., Komuna e R., që në emër të borxhit ti paguaj shumën e përgjithshme prej 17,000,00 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm. III. OBLIGOHET i padituri që paditësit t’i paguaj shpenzimet procedurale në shumë prej 1,018.00 Euro, po ashtu në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit”.

Kundër këtij Aktgjykimi, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe konstatimin e gabuar të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e

Apelit, ankesën e të paditurit ta aprovojë të bazuar, ndërsa aktgjykimin e ankimuar, ta ndryshojë ashtu që të refuzohet e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit, ose ta prishë dhe çështjen të ia kthejë në rigjykim, në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata e Apelit si Gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa është e përfaqësuesit të paditurit, është e pa themeltë

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me datë 30.12.2011, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi për pagimin e borxhit, për të cilin borxh ka kërkuar që të detyrohet i padituri, që paditësit për shkak të mospërbushje së borxhit, t'ia paguajnë shumën prej 10,000.00 euro si dhe në emër të fitimit të humbur t'ia paguaj shumën prej 5,576.00 euro.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit dhe pas administrimit të provave ka marrë aktgjykimin C.nr.333/17 i datës 27.10.2021, me të cilin e ka aprovuar të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të atakuar ka theksuar se pasi që ka vërtetuar faktet vendimtare në lidhje me këtë çështje juridike, siç është deklarata e të paditurit e datës 13.05.2011, deklarimi i të paditurit për pohimin e borxhit në seancën e datës 23.03.2012 dhe seancën e datës 30.03.2012 të dhënë në këtë gjykatë, deklarimin e dëshmitarit E. M. të dhënë e seancën e datës 05.10.2021, si dhe deklarimin e paditësit të dhënë në cilësinë e palës në procedurë. Andaj gjykata e shkallës së parë bazuar në nenin 8 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), është paraparë se *“Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit”*, ndërsa me nenin 245 të po këtij ligji, është paraparë se *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e shkallës së parë, vendimin mbi shpenzimet e procedurës vendosi në bazë të nenit 452 paragrafi 1 të LPK-së dhe në pajtim me tarifën e odes së avokatëve.

Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform neneve 4,5,7,8,dhe 10 lidhur me nenet 143 dhe 146 të LPK-së.

Gjykata e Apelit, nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi LPK-së, nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 LPK-së. Aktgjykimi nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitiv i aktgjykitimit është i qartë e në harmoni të plotë me arsyetimin e aktgjykitimit. Në arsyetim të aktgjykitimit janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykitimit janë dhënë arsyeje të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë-dhe fuqisë provuese të tyre.

Gjykata e Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, është përmbajtur kërkesave ligjore për strukturën dhe përmbajtjen e aktgjykitimit dhe në këtë mënyrë ka nxjerrë një aktgjykim i cili në pikëpamje logjike dhe juridike është në harmoni dispozitiv me arsyetimin, dhe arsyetimi është në koherencë të plotë në tërësinë e tij. Nga arsyetimi i aktgjykitimit rezulton se gjykata e shkallës është thelluar në masë të mjaftueshme në kontestin e palëve duke identifikuar dhe provuar të gjitha faktet thelbësore mbi bazën e të cilave ka arritur në përfundim e duhur për themelësinë e kërkesëpadisë.

Gjykata e Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, drejt e ka vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të drejtë dhe të plotë, sepse siç u cek edhe më lartë gjykata e shkallës së parë i ka provuar të gjitha faktet vendimtare kur ka vendosur lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Nuk qëndrojnë pretendimet e parashtruesit të ankesës se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar gjendjen faktike, për shkak se në arsyetim të aktgjykitimit të atakuar gjykata e shkallës së parë e potencon se ka administruar si provë, deklaratën e të paditurit të datës 13.05.2011, e cila është e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prizren dhe mban shenjën Vr.nr.3858/2011 e datës 13.05.2011, nga e cila konstatohet se i padituri e pohon borxhin lëndor të kërkuar nga paditësi më kërkesëpadi, të njëjtin deklaram i padituri e deklaroi edhe në seancat e datave 23.03.2012 dhe 30.03.2012, të dhëna në Gjykatën Komunale në Rahovec, poashtu gjykata e shkallës së parë, ka dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit E. M., që sipas deklaramit të tij, në seancën e datës

05.10.2021, më ndërgjyqësit ka raport të vjetër të miqësisë, nga i njëjti konstatohet se paditësi ja ka dhënë të paditurit huan e kërkuar si në kërkesëpadi nga paditësi, për dy muaj, por i padituri nuk ka mundur t'i kthej mjetet financiare, e cila deklaratë e këtij dëshmitari është në harmoni të plotë me shkresat tjera të lëndës dhe në harmoni edhe me vetë pohimin e kërkesës të paditurit, në deklaratën e tij të lartcekur, prandaj pretendimi i përfaqësuesit të përkohshëm të paditurit, se nuk është vërtetuar gjendja faktike, është i pabazuar sepse në këtë rast jo që nuk është vërtetuar gjendja faktike por në fakt kemi pohim të kërkesës së paditësit nga ana e të paditurit, por më gjithë atë gjykata e shkallës së parë ka administruar edhe prova të tjera, në vërtetësinë objektit të kësaj çështje kontestimore.

Duke pasur parasysh faktin se është detyrë e çdo pale në procedurë që të sjellin prova të mjaftueshme në mënyrë që të bazojnë themelësinë e kërkesës së tyre, e që në rastin konkret përfaqësuesi i palës së paditur, me asnjë provë e po ashtu as me ankesë nuk ka mundur të vërtetojë pretendimet e tij, andaj edhe kjo gjykata nuk gjeti arsye për vendosje ndryshe, se në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar edhe të drejtën materiale, sepse palët-ndërgjyqësit që në këtë rast i padituri më deklarimin e tij të datës 13.05.2011, e cila është e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prizren dhe mban shenjën Vr.nr.3858/2011 e datës 13.05.2011, ka krijuar të drejta dhe detyrime, në raport më paditësin, duke e pohuar se nga paditësi i ka pranuar, shumën e mjeteve financiare prej 20,000.00 euro, të cilat mjete është zotuar i padituri se do ti kthej deri me datë 31.12.2011, në të kundërtën vetë i padituri e ka deklaruar se e cakton në garancion shtëpinë e tij 4 katshe, që gjendet në K., Komuna e R., me një sipërfaqe prej 8 ari. Nga ky deklaram i të paditurit, rezulton se është përmbushur kërkesa, i cili deklaram i të paditurit e ka fuqinë e një kontratë të lidhur mes ndërgjyqësve, meqenëse pohohet nga i padituri se është përmbushur e njëjta, andaj deklarimin si të tillë – marrëveshjen, i padituri nuk ka mundur ti kthej mjetet financiare, prandaj në rastin konkret të paditurin me të drejtë është obliguar nga gjykata e shkallës së parë, për kthimin e shumës së mjeteve financiare prej 17,000.00 euro, sa edhe është kërkuar nga paditësi më kërkesëpadi.

Me nenin 132 paragrafi 2 i LMD-së (Ligji i Marrëdhënieve të Detyrimeve-i vjetri), “ *Në qoftë se njëra palë ka plotësuar kontratën tërësisht ose pjesërisht ka të drejtë t'i kthehet ajo që ka dhënë*”, gjë që në rastin konkret pala paditëse ka kërkuar vetëm kthimin e asaj që është paguar në bazë të kërkesë së paditësi dhe deklarimit të tij sipas deklaratës së datës 13.05.2011, e cila është e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prizren dhe mban shenjën Vr.nr.3858/2011 e datës 13.05.2011.

Sa i përket vendimit për shpenzimet procedurale të gjykuara nga gjykata e shkallë së parë, edhe gjykata e Apelit e përkrah një vendim të tillë pasi që shpenzimet e aprovuara janë shpenzime në përputhshmëri të plotë me veprimet procedurale, e gjithashtu duke pas parasysh edhe suksesin e paditësit në procedurë dhe atë në kuptim të nenit 452.2 të LPK-së.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ac.nr.1098/2022 të datës 28.10.2024

Gjyqtari  
Adnan Konushevcı d.v